



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 88/K Prot.

Durrës, më 17.01.2020

VENDIM

Nr. 8, datë 17.01.2020

“ Mbi përcaktimin e statusit “Student Përsëritës “

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 3, të VKM nr. 288, datë 21.05.2018 “Për përcaktimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, të shkresës së Administratorit nr. 1685 prot, datë 16.10.2019, të shkresës nr. 1685/1 datë 12.11.2019 të Drejtorisë së Burimeve Njerzore dhe Juridike Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 17.01.2020,

V E N D O S I :

1. Studentë përsëritës në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës quhen ata studentë të cilët janë duke kryer studimet jashtë kohës normale të studimeve, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, në ciklin e parë të studimeve bachelor dhe në studime profesionale.
2. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohen :
 - Zv.Rektorët
 - Administratori
 - Dekanët e Fakulteteve
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksanela SOTIROESKI